

VENDIM
Nr. 594, datë 31.8.2016

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT “VÏJA BREGDETARE E QYTETIT TË VLORËS, FAZA 1, SHTESAT, PJESA LINDORE”, VLORË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 160/2014, “Për buxhetin e vitit 2015”, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Urban, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Vija bregdetare e qytetit të Vlorës, faza 1, shtesat, pjesa lindore”, Vlorë.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Bashkisë Vlorë.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë sipërfaqe “tokë truall” dhe “ndërtesë”, me një vlerë të përgjithshme prej 356 185 311.76 (treqind e pesëdhjetë e gjashtë milionë e njëqind e tetëdhjetë e pesë mijë e treqind e njëmbëdhjetë pikë shtatëdhjetë e gjashtë) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 356 185 311.76 (treqind e pesëdhjetë e gjashtë milionë e njëqind e tetëdhjetë e pesë mijë e treqind e njëmbëdhjetë pikë shtatëdhjetë e gjashtë) lekësh, të përballohet nga llogaria “Fondi i shpronësimeve”, në Bankën e Shqipërisë.

5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga buxheti i vitit 2016, miratuar për Ministrinë e Zhvillimit Urban.

6. Shpronësimi të fillojë më 2 shtator 2016.

7. Pronarët e përmendur në listën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Bashkisë Vlorë.

8. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Vlorë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Bashkinë Vlorë, të fillojë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën treguese të regjistrimit, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe të bëjë kalimin e pronësisë për pasuritë e shpronësuara në favor të shtetit.

9. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Vlorë të pezullojë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në momentin kur do të realizohen procesi i hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën treguese të regjistrimit dhe kalimi i pronësisë për pasuritë e shpronësuara.

10. Ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Zhvillimit Urban, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Vlorë dhe Bashkia Vlorë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

LISTA E PASURIVE TË PALUAJTSHME PRONË PRIVATE,
TË CILAT PREKEN NGA PROJEKTI SKELE - UJI I FTOHTË, BASHKIA VLORË

TABELA 2/A

Nr.	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Pronari	Sipërfaqe truallit	Sipërfaqe ndërtimi	Çmimi i truallit, lekë	Çmimi i ndërtimit, lekë	Vlera e truallit, lekë	Vlera e banesës, lekë	Vlera truall dhe ndërtësë ose truall dhe banesë	Shënime
SHTESA NË ZONËN I SKELE - SHKOLLA E MARINËS											
1	8602	23/8-T	Sade Gjonzeneli	222.90	0.00	10,903		2,430,278.70	0.00	2,430,278.70	Konfirmuar nga ZVRPP-Vlorë
2	8602	27/53+2-1	B.P. Hodaj	0.00	82.63	10,903	61,117	0.00	4,149,182.82	4,149,182.82	Konfirmuar nga ZVRPP-Vlorë, mbajtur vlera e truallit për pjesën e ndërtimit. Urdhër kufizimi
3	8602	27/53+3-1	B.P. Balili	52.00	52.00	10,903	61,117	566,956.00	2,611,128.00	3,178,084.00	Konfirmuar nga ZVRPP-Vlorë, mbajtur vlera e truallit për pjesën e ndërtimit. Urdhër kufizimi
4	8602	23/96+1-5	Bp Metushi, Jaupaj, Borici, Koka, Bajrami, Anagnosti	53.70	53.70	10,903	61,117	585,491.10	2,696,491.80	3,281,982.90	Saktësim dokumentacioni
5	8602	27/49	Taulant Llanaj	32.00	32.00	10,903	61,117	348,896.00	1,606,848.00	1,955,744.00	Saktësim dokumentacioni
6	8602	27/378	P.P.V	396.50		10,903		4,323,039.50	0.00	4,323,039.50	Saktësim dokumentacioni
7	8602	26/34-ND	P.P.V	16.00	16.00	10,903	61,117	174,448.00	803,424.00	977,872.00	Saktësim dokumentacioni Truallit është në pronësi Shtet
8	8602	24/152	Engjell Pazaj	21.80		10,903		237,685.40	0.00	237,685.40	Saktësim dokumentacioni
9	8602	24/50	P.P.V	74.80	0.00	10,903		815,544.40	0.00	815,544.40	Saktësim dokumentacioni
10	8602	24/149	Zamir Llangozi	72.00	0.00	10,903		785,016.00		785,016.00	Konfirmuar nga ZVRPP-Vlorë.
11	8602	26/22-T	Sulejman Shehi	2.30	0.00	10,903		25,076.90	0.00	25,076.90	Konfirmuar nga ZVRPP-Vlorë.
12	8602	27/102	Antigoni Ngresi, Vangjel Koci, Dhimiter Koci, Afroviti Dodani, Vasil Koci	1.00	0.00	10,903		10,903.00	0.00	10,903.00	Konfirmuar nga ZVRPP-Vlorë. Urdhër kufizimi.
13	8602	27/47	B.P. Muco	56.70		10,903		618,200.10	0.00	618,200.10	Konfirmuar nga ZVRPP-Vlorë
14	8602	23/99+1-1	B.P. Nushi	9.10	0.00	10,903		99,217.30	0.00	99,217.30	Konfirmuar nga ZVRPP-Vlorë. Vlera e dhënë është diference e pallogaritur në VKM 661
SHTESA NË ZONËN II SHKOLLA E MARINËS - UJI I FTOHTË											
1	8602	42/429	Skender Gjondeda	288.20	0.00	10,903		3,142,244.60	0.00	3,142,244.60	Konfirmuar nga ZVRPP-Vlorë
2	8602	42/430	Hader Gjondeda	208.70	0.00	10,903		2,275,456.10	0.00	2,275,456.10	Konfirmuar nga ZVRPP-Vlorë
3	8602	42/428	Evis Shehi	112.20	0.00	10,903		1,223,316.60	0.00	1,223,316.60	Konfirmuar nga ZVRPP-Vlorë
4	8602	36/150-ND1	Arjan Lengu	0.00	210.00	10,903	61,117	0.00	10,544,940.00	10,544,940.00	Konfirmuar nga ZVRPP-Vlorë, mbajtur vlera e truallit për pjesën e ndërtimit. Urdhër kufizimi. Ndërtim 2 kate
5	8602	36/242-ND	Arjan Lengu	0.00	120.00			0.00	0.00	2,775,001.00	Konfirmuar nga ZVRPP-Vlorë. Vlera e dhënë është diference e pa llogaritur në VKM 661 dhe sipas situacionit
6	8602	36/150-ND2	Arjan Lengu	0.00	35.18			0.00	0.00	1,414,636.00	Konfirmuar nga ZVRPP-Vlorë. Vlera e dhënë është sipas situacionit
7	8602	42/39	Selim Gjondeda	267.80	47.80	10,903	61,117	2,919,823.40	2,400,229.20	5,320,052.60	Saktësim dokumentacioni
8	8602	42/39-ND	Sofo Selimaj	0.00	110.00	10,903	61,117	0.00	5,523,540.00	5,523,540.00	Konfirmuar nga ZVRPP-Vlorë. Inskriptuar në favor të bankës kombëtare tregtare. Mbajtur vlera e truallit për ndërtimin
9	8602	42/406-ND	Majlinda Hajrullai	0.00	12.00	10,903	61,117	0.00	602,568.00	602,568.00	Konfirmuar nga ZVRPP-Vlorë
10	8602	42/443	P.P.V	52.70	0.00	10,903		574,588.10	0.00	574,588.10	Saktësim dokumentacioni
11	8602	36/242	Mbivendosje	87.31	0.00	10,903		951,940.93	0.00	951,940.93	Konfirmuar nga ZVRPP-Vlorë

12	8602	36/34	Artur Shehu	1300.00	0.00	10,903		14,173,900.00	0.00	14,173,900.00	Konfirmuar nga ZVRPP-Vlorë
13	8602	36/233	Mbivendosje	101.43	0.00	10,903		1,105,891.29	0.00	1,105,891.29	Konfirmuar nga ZVRPP-Vlorë
14	8602	36/265	Mbivendosje	83.30	0.00	10,903		908,219.90	0.00	908,219.90	Konfirmuar nga ZVRPP-Vlorë
15	8602	41/305	Mbivendosje	249.80	0.00	204		50,959.20	0.00	50,959.20	Konfirmuar nga ZVRPP-Vlorë (ZVRPP Pemëtores)
16	8602	41/169-ND2	B.P. Gjika, Aliaj	0.00	76.00	10,903	61,117	0.00	3,816,264.00	3,816,264.00	Konfirmuar nga ZVRPP-Vlorë. Mbajtur vlera e truallit në ndërtim
17	8602	36/29-ND	Neta Hasanaj	0.00	107.83	10,903		0.00	22,703,933.00	22,703,933.00	Konfirmuar nga ZVRPP-Vlorë, vlera është dhënë sipas situacionit.
18	8602	41/5	B.P. Koleka, Kajana	1.70	0.00	10,903		18,535.10	0.00	18,535.10	Konfirmuar nga ZVRPP Vlorë. Mbi këtë pasuri ndodhen disa AMTP
19	8602	41/353	B.P. Papalilo	1782.60	0.00	10,903		19,435,687.80	0.00	19,435,687.80	Konfirmuar nga ZVRPP-Vlore. Kufizohen veprimet mbi pasurinë, në proces gjyqësor. Mbi këtë pasuri ndodhen disa AMTP
20	8602	36/22	Cenaj & CO	6.60	0.00	10,903		71,959.80	0.00	71,959.80	Konfirmuar nga ZVRPP-Vlorë
21	8602	36/88	B.P. Vokopola	1718.60	0.00	10,903		18,737,895.80	0.00	18,737,895.80	Saktësim dokumentacioni

138,259,356.84

PASURITË NË PJESËN PERËNDIMORE TË RRUGËS DHE NË PJESËN LINDORE (PJESA E GJELBËRIMIT) TË PROJEKTIT TË VIJA BREGDETARE E QYTETIT TË VLORËS, FAZA I

Tabela 2/b

truallit sipas VKM 89/2016= 10903 lekë/m²

Nr.	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Pronari	Sipërfaqe truallit	Sipërfaqe ndërtimi	Çmimi i truallit, lekë	Çmimi i ndërtimit, lekë	Vlera e truallit, lekë	Vlera e ndërtimit, lekë	Vlera truall dhe ndërtësë	Konfirmimi i ZVRPP-Vlorë
1	8602	35/143	Vaja, B.p Jazaj, Idrizaj, Murataj, Shehu, Sina, Muca, Hyso etj..	4237.38		10,903		46,200,154.14	0.00	46,200,154.14	Konfirmuar nga ZVRPP Kontratë sipërmarrje me nr. 1878 Rep. në favor të “Materia-Cons.AL”
2	8602	41/390	Bp Velaj , Haxhiu	423.19		10,903		4,614,040.57	0.00	4,614,040.57	Konfirmuar nga ZVRPP. AMTP, Kadrie Xhaferri
3	8602	41/353	Bp Papalilo	14474.75		10,903		157,818,199.25	0.00	157,818,199.25	Konfirmuar nga ZVRPP. Kufizohen veprimet.
4	8602	41/307	Lumturi Vladimir Varfi	1500.00		204		306,000.00	0.00	306,000.00	Konfirmuar nga ZVRPP /Ullishte
5	8602	41/403	Bp Velaj	118.45		10,903		1,291,460.35	0.00	1,291,460.35	Konfirmuar nga ZVRPP
6	8602	41/169	Bp Gjika, N. Aliaj	705.87		10,903		7,696,100.61	0.00	7,696,100.61	Konfirmuar nga ZVRPP.AMTP

217,925,954.92

TOTALI TAB.2/A + 2/B

356,185,311.76